



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 389/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Fryma e Re (FER), me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit të posterit, në seancën e panelit të mbajtur me 12.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET ankesa si e bazuar e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Frymës së Re (FER), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 1500 (njëmijepesëqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 09.12.2010, nga subjekti politik PDK në te cilën pretendohet se më datë 09.12.2010, të “Qendra Rinore” në Ferizaj, subjekti politik FER, ka mbuluar posterin e subjektit politik PDK, me posterin e tyre, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur 1 (një) fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë se posterit i subjektit politik FER, është vendosur mbi posterin subjektit politik PDK. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik FER, më datë 10.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri më datë 11.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, nuk mori përgjigje në ankesë nga subjekti politik FER, sipas afatit të caktuar.

Veprimet e Ndalura të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjësi si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- **ankesa është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se posteri i subjektit politik FER, është vendosur mbi posterin e subjektit politik PDK. Andaj për arsyet e lartcekura, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 389/2010 më datën 12.12.2010

